



SKEMA.. KOMBËTARE — 2024



Telefono falas
08008383



azhbr.gov.al

**MBËSHTETJE PËR INVESTIME NË
FERMA DHE AKUAKULTURË
30 Shtator - 8 Nëntor**



MASA 1

NDËRTIMI I SERRAVE DIELLORE TË REJA

Sipërfaqe jo më pak se **0.2 ha** (dy dynym) dhe jo më shumë se **2 (dy)** ha për subjekt, përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes. Masa e përfitimit të jetë në **50%** të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se:

-**15,000,000** (pesëmbëdhjetë milion) lekë/ha për serrat e prodhimit të perimeve;
-**8,000,000** (tetë milion) lekë/ha për serrat e prodhimit të rrushit për tavolinë;
-**4,000,000** (katër milion) lekë/ha për serrat (tunelet plastike) të prodhimit të luleshtrydheve.

MASA 2

RRJETA PËR MBROTJEN E PRODHIMIT NGA BRESHËRI NË BLOQET EKZISTUESE ME PEMË FRUTURE, AGRUME DHE VRESHTA.

Masa e përfitimit të jetë në **50%** të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **1 500 000** (një milion e pesëqind mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se **1 (një)** ha dhe jo më shumë se **5 (pesë)** ha.

MASA 3

NDËRTIMI I AMBIENTEVE PËR MBARËSHTIMIN E KAFSHËVE DHE STABILIMENTEVE PËR RRRITJEN E SHPENDËVE

Me kapacitet jo më pak se **10 (dhjetë)** lopë, jo më pak se **100 (njëqind)** të imta, jo më pak se **10 (dhjetë)** dosa dhe jo më pak se **10,000 (dhjetë mijë)** shpendë. Masa e përfitimit të jetë në **50%** të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **15,000,000** (pesëmbëdhjetë milion) lekë për subjekt.

MASA 4

BLERJA E TRAKTORËVE, MAKINERIVE DHE PAJISJEVE PËR MEKANIZIMIN DHE MODERNIZIMIN E PROCESIVE TË PUNËS NË FERMAT BUJQËSORE DHE BLEGTORALE.

Masa e përfitimit të jetë në **50%** të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **5,000,000** (pesë milion) lekë për subjekt.

MASA 5

MBËSHTETJE PËR AKUAKULTURËN DETARE PËR KOSHAT DHE RRJETAT E RRRITJES SË PESHKUT

Masa e përfitimit të jetë në **50%** të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **20,000,000** (njëzet milion) lekë për subjekt.

APLIKIMI PËR MASAT MBËSHTETËSE TË INVESTIMEVE

- Informacioni i nevojshëm për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimit dhe procedimit deri në përfitimin e mbështetjes financiare gjendet pranë Agropikave, pranë Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Zyrave Qendrore të AZHBR si dhe në faqen e internetit: www.azhbr.gov.al dhe www.mbzhr.gov.al.
- Aplikimet për masat mbështetëse të investimeve me nr. 9-13 do të bëhen me dosje fizike në zyrat qendrore të AZHBR;
- Për qëllime identifikimi, aplikanti sipas statusit përkatës (fermer individual / person fizik / juridik), ose përfaqësuesi i tij me prokurë ose autorizim, duhet të paraqitet në zyrat qendrore të AZHBR-së me letërnjoftim elektronik ose pasaportë biometrike.
- Aplikimet për masat mbështetëse të investimeve do të bëhen nga data **30.9.2024** deri më **8.11.2024**, brenda orarit zyrtar.

